



Duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.5 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV Nr.05/2011/KRPP

Pjesa 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që ti mundësojë Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik që të realizoj monitorimin e njoftimeve për publikimin e prokurimeve publike në pajtueshmëri me Nenin 42.2 të Ligjit të Prokurimit Publik nr.03/L-241.

Pjesa 2 Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzues, kanë kuptimin e përkufizimeve të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-241 për Prokurimin Publik.

Pjesa 3 Korrigjimi dhe dërgimi i njoftimeve për publikim në gazeta

Nëse KRPP-ja brenda dy (2) ditëve nga pranimi i njoftimit për kontratë ka kërkuar përmirësim të gabimeve apo mangësive në njoftimin për kontratë, Autoritetet Kontraktuese mund të dërgojnë njoftimin për kontratë për publikim në gazeta vetëm nëse janë korrigjuar gabimet apo mangësitë e përmendura.

Dërgimi i njoftimit për kontratë për publikim në gazeta nuk mund të kryhet përderisa KRPP nuk ka publikuar te njëjtin ueb faqen e saj.

Njoftimi për shpërbim të kontratës duhet të dërgohet në të njëjtën kohë në KRPP dhe në gazeta.

Pjesa 4 Përgjegjësitë e autoriteteve kontraktuese

Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara që të implementojnë këtë Udhëzim Administrativ kur bëjnë publikimin e njoftimeve në gazeta.

Pjesa 5 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Prishtinë,
Data 19.05.2011

Safet Hoxha,
Kryetar i KRPP-së

